

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Basti" me vdekjen/ 7 njerëz ruhen në -196°C me shpresën se do të ringjallen pas 250 vitesh
ADRESA	https://www.gazetatema.net/lifestyle/basti-me-n-7-njerez-ruhen-ne-196c-me-shpresen-se-do-te-ringjalle-i586053
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 14:02:36 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 15:04:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8c7f70173d3d688d8866616603a9365b546878380ad5169a5f9f907d565329d2
TEKSTI	171364f2f70b78bcef6b3e4b2460f43fd2a3358a2f24f67c9fdb3f7afe64f5b5
PAMJA	cfebcb72c59d73aa051752490977bc2f4bebee90696729b5c900e4d9f1c7ad2e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	cc74e47c33335e3306488585c6d10fc0fc57299cd4c329762e41ff7367693ff5
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	6e410cf6c3be6bd40f75161c1288a8066fcd1b6e7ab80a3c789507dd842f2954
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/cc74e47c33335e3306488585c6d10fc0fc57299cd4c329762e41ff7367693ff5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



le [Brazë i ashpër me KLGJ dhe KLP për vendimet për pagat: Ne thesarin nuk fut dot doren kushdo, s'i ve dot kush shkelmin parave të shqiptareve! Regjet në panik: Ai dhe n](#)
fundit

“Basti” me vdekjen/ 7 njerëz ruhen në -196°C me shpresën se do të ringjallen pas 250 vitesh



14 Shtator 2026, 17:04Lifestyle TEMA



Shtatë njerëz të vdekur po ruhen në temperaturën ekstreme prej -196 gradë Celsius, në një objekt të izoluar në Holbrook të New South Wales, Australi, me shpresën se një ditë shkenca do të jetë në gjendje t'i rikthejë në jetë.

Bëhet fjalë për një qendër krioprezervimi të kompanisë Southern Cryonics, e cila prej vitit 2023 ruan trupa njerëzorë në rezervuarë të mëdhenj të mbushur me azot të lëngshëm.

Sipas The Guardian, shtatë personat janë vendosur me kokën poshtë në rezervuarët metalikë, të njohur si “dewars”, ku temperatura mbahet në rreth -196°C. Kompania u ofron klientëve atë që e përshkruan si një mundësi për zgjatjen e jetës, edhe pse nuk ka asnjë garanci se ata do të mund të rikthehen ndonjëherë në jetë.

Procedura nis menjëherë pas vdekjes. Trupi ftohet sa më shpejt dhe më pas i nënshtrohet një procesi të quajtur vitrification, gjatë të cilit përdoren substanca krioprotektive për të kufizuar dëmtimin e qelizave nga temperaturat ekstreme.

Pas stabilizimit, trupi transportohet në objektin e Southern Cryonics dhe vendoset në azot të lëngshëm për ruajtje afatgjatë.

Kjo procedurë nuk është aspak e lirë. Sipas The Guardian, kostoja fillestare e stabilizimit është rreth 60 mijë dollarë australianë, ndërsa ruajtja afatgjatë kushton rreth 150 mijë dollarë australianë. Kompania u kërkon klientëve gjithashtu një tarifë vjetore anëtarësimi.

Por pyetja më e madhe mbetet: a do të jetë ndonjëherë e mundur ringjallja e tyre?

Peter Tsolakides, drejtuesi i Southern Cryonics, nuk premton një rezultat të tillë. Ai vlerëson personalisht se mundësia që teknologjia e nevojshme për ringjalljen e këtyre personave të ekzistojë pas rreth 250 vitesh është vetëm 10%.

Shkencëtarët janë edhe më skeptikë. Ekspertë të krioprezervimit argumentojnë se teknologjia aktuale nuk është në gjendje të ruajë në mënyrë të përsosur një

trup të tere, veçanësisht trurin dhe udhjet komplekse ndërmjet qelizave nervore.

Edhe nëse trupi do të ruhej për shekuj, mbetet një problem tjetër: sëmundja ose dëmtimi që shkaktoi vdekjen do të duhej të kurohej nga teknologjia e së ardhmes.

Pavarësisht skepticizmit shkencor, njerëzit që zgjedhin krioprezervimin e shohin atë si një bast. Nëse ringjallja do të bëhej ndonjëherë e mundur, ata do të kishin një shans për t'u rikthyer në jetë; nëse jo, procesi do të mbetet vetëm një eksperiment i pazakontë mbi kufijtë e shkencës.

Për momentin, shtatë trupat në Holbrook vazhdojnë të ruhen në -196°C, në pritje të një teknologjie që sot nuk ekziston.

Burimi: The Guardian

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

["Iku një pjesë e shpirtit tim" / Genta Ismajli humb babain, dedikimi prekës i këngëtares](#)

15:30 Lifestyle

["Lavatriçja për njerëzit" hyn në përdorim real, Japonia nis shitjen e shpikjes që lan dhe than trupin në 15 minuta](#)

14:55 Lifestyle / 1 koment

[FOTOT/ Lady Gaga bëhet nënë për herë të parë, fotoqrohet me foshnjën në krahë](#)

14:16 Lifestyle / 1 koment

[VIDEO/ Putin fliste në Samitin e BRICS, zyrtarët indianë “kapen mat” duke ngrënë, pamjet bëjnë xhiron e rrjetit](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.